

ERDHI KOHA TË SHKUNDEN XHEPAT*

Kartëmonedhat dhe monedhat euro do të qarkullojnë me kurs ligjor nga 1 janari 2002. Qeveritë europiane, shitësit me pakicë dhe bankat janë duke u përgatitur për një ushtrim logjistik pa precedent i cili do ta tendosë sistemin bankar deri në kufijtë e tij - Raporton Bankieri European.

Dita e martë, 1 janar 2002, është ditë pushimi për bankat në të gjithë Europën, megjithatë, në këtë ditë, shumë banka do të jenë hapur ose duke punuar, prapa dyerve të mbyllura për publikun.

Janë duke u shtypur më shumë se 14 miliardë kartëmonedha euro me një vlerë rreth 642 miliardë euro. Po kështu po prodhohen rreth 50 miliardë monedha euro me një vlerë prej 16 miliardë euro dhe një peshë rreth 250,000 tonë.

Të gjitha këto duhet të shpërndahen deri në fund të vitit të ardhshëm, por detyra e stërmadhe logjistike nuk mbaron këtu. Në fillim të vitit që vjen, një sasi e krahasueshme monedhash dhe kartëmonedhash kombëtare duhet të tërhiqet nga qarkullimi për t'u asgjësuar apo për t'u shkrirë.

Detyrë e rëndësishme

Detyra e tejkalon disa herë kapacitetin shpërndarës të sistemit financiar europian. Për këtë arsye ajo do të realizohet nëpërmjet furnizimit të bankave dhe më pas furnizimit të shitësve me pakicë si edhe institucioneve të tjera, të cilat kalojnë nëpër duar sasi të konsiderueshme parash, gjatë periudhës shtator-dhjetor 2001.

Katër parimet

Furnizimi i bankave bazohet mbi katër parime të hartuara nga Këshilli i Ministrave (ECOFIN) në nëntor të vitit 1999:

Shtetet anëtare do të përcipen të sigurojnë që pjesa më e madhe e transaksioneve në para të bëhet në euro që prej fillimit të gjysmës së dytë të janarit 2002.

Institucionet financiare dhe lojtarë të tjerë të rëndësishëm mund të pajisen me kartëmonedha dhe monedha euro përpara datës 1 janar 2002, në mënyrë që kalimi nga monedhat kombëtare në euro të jetë më i lehtë. Kjo lëvizje, gjithësesi nuk do të thotë që euro do të fillojë të përdoret në këto vende përpara datës 1 janar 2002.

Paketa të vogla me monedha euro mund të shpërndahen në publik gjatë gjysmës së dytë të dhjetorit 2001, në mënyrë që publiku – dhe sidomos pjesët më të prekshme të tij – të familjarizohet me monedhën e re.

Periodha e qarkullimit të dyfishtë duhet të zgjasë nga katër javë deri në dy muaj megjithëse vendet anëtare mund të lehtësojnë këmbimin e kartëmonedhave dhe të monedhave të vjetra edhe pas kësaj kohe.

Udhëzime të Bankës Qendrore Europiane

Banka Qendrore Europiane (BQE) dhe Komisioni kanë hartuar udhëzime të detajuara lidhur me furnizimin e institucioneve të kreditit me monedha dhe me kartëmonedha euro.

☞ Data e parë për furnizimin e institucioneve të kreditit me monedha dhe kartëmonedha euro, dhe për shpërndarjen e këtyre parave prej institucioneve të kreditit të kompanitë ku paratë qëndrojnë “në transit” (për një periudhë kohe të kufizuar), si për shembull tek shitësit me pakicë apo tek makinat që realizojnë shitje automatike mallrash, është 1 shtatori.

☞ Institucionet e kreditit nuk do të debitoohen gjatë këtij viti për kartëmonedhat dhe monedhat euro me të cilat ato do të furnizohen. Vlera e kësaj paraje do të debitet në tre

* European Banker, korrik 2001, faqe 14,15.

shuma të barabarta gjatë vitit të ardhshëm në datat 2, 23 dhe 30 janar.

- ✍ Për furnizimin e institucioneve të kreditit nuk do të kërkohet kolateral përpara 1 janarit të vitit 2002, por këto institucione bartin rrezikun që rrjedh nga kartëmonedhat dhe monedhat euro, që mund të shkatërrohen apo të vidhen. (Rregullat për kolateralizim ndryshojnë nga njëri shtet në tjetrin).
- ✍ Në rastet kur institucionet e kreditit furnizojnë njësi të tjera me monedha dhe me kartëmonedha euro, këto institucione duhet të paraqesin kolateral pranë bankës qendrore në momentin kur bëhet kjo shpërndarje.
- ✍ Gjatë periudhës së qarkullimit të dyfishtë (euro dhe monedhë vendase), klientëve të bankave duhet t'u krijohen mundësitë që të këmbëjnë kartëmonedha dhe monedha pa pagesë në shuma të pakufizuara (duke patur parasysh që këmbimet për shuma të mëdha të njoftohen përpara se të ndodhin). Joklientëve duhet t'u krijohen të njëjtat mundësi (këmbim pa pagesë), por ata do të jenë subjekt i tavaneve përpara se të përket shumave të parave që do të këmbëhen.
- ✍ Në mënyrë që të lehtësohet kthimi i restove, aty ku do të shpërndahen para do të ketë furnizim me shuma të mjaftueshme kartëmonedhash dhe monedhash që në ditët e para të vitit 2002.
- ✍ Shitësit më pakicë do të inkurajohen të paguajnë vetëm në euro që nga fillimi i janarit 2002.

Rreth një e katërta e kartëmonedhave dhe një e treta e monedhave priten që të përdoren për furnizim. Bankat qendrore kombëtare kanë marrë nga bankat dhe disa firma vendase vlerësime të shumave për të cilat ato kanë nevojë.

Bankat nga ana e tyre duhet të diskutojnë kushtet e furnizimit me shitësit me shumicë, duke pasur parasysh që asnjë nga njësitë e furnizuara prej bankave nuk mund të debitohet për paratë e marra përpara datës 2 janar 2002, gjë që do të thotë që bankat ballafaqohen me njëfarë rreziku të kredidhënies.

Qarkullimi i dyfishtë

Fillimisht u mendua që periudha e qarkullimit të dyfishtë të ishte 6 muaj, por ajo u shkurtua në dy muaj në vitin 1999 sipas kërkesës së shitësve me pakicë dhe në kundërshtim me preferencën e bankave. Disa shtete kanë përcaktuar një periudhë akoma më të shkurtër se kjo për qarkullimin e dyfishtë.

ECOFIN synon që tre të katërtat apo më tepër pjesë të transaksioneve të kryhen në euro në mesin e janarit të vitit 2002.

Çështja kyçe në këtë mes është se, kur kapaciteti i shpërndarësve automatikë të parasë (ATM) do të jetë në gjendje për të shpërndarë euro. Austria, Belgjika, Gjermania dhe Holanda gjykojnë se do të jenë në gjendje t'i përdorin ATM-të e tyre për shpërndarjen e euros si gjatë ditës ashtu edhe gjatë natës.

Finlanda, Italia dhe Greqia kanë nevojë për një periudhë dyjavore për të përgatitur ATM-të e tyre, ndërsa vendet e tjera anëtare gjykojnë se mjafton një periudhë më e shkurtër se kjo. Shumë ATM që nuk janë të përshtatshme për konvertim të parasë do të tërhiqen nga përdorimi.

Marrëveshjet për konvertimin e vazhduar të monedhave dhe të kartëmonedhave kombëtare janë të ndryshme. Në vendet ku janë vendosur kufij kohorë, këta kufij janë "bujarë".

Bankat qendrore kanë bërë marrëveshje kombëtare me bankat e tjera, disa prej të cilave do të kërkojnë pagesë komisionesh për klientët dhe joklientët.

Çfarë mund të mos ecë sipas parashikimeve

Shumica e bankave duhet të jenë në gjendje të sigurojnë kapacitetet për furnizimin me monedha dhe kartëmonedha euro. Disa nga shitësit me pakicë mund të hasin probleme lidhur me vendruajtjen e parave ose me sigurimin e tyre, gjë që mund t'i detyrojë ata të kërkojnë ndihmën e bankave.

Shtetet e vogla mund të kenë një numër të mjaftueshëm mjetesesh të sigurta për shpërndarjen e parave, ndërkohë që disa shtete të tjera kanë vendosur të përdorin transportin ushtarak.

Edhe planet më të mira, të hartuara për këtë ushtrim logjistik që do të bëhet në mes të dimrit, mund të prishen apo të pengohen nga moti i keq. Në mbështetje të planeve primare janë hartuar plane që marrin parasysh ngjarje të ndryshme të paparashikuara, por edhe këto mund të mos jenë mbrojtja më e mirë nga kushtet e ashpra. Veprimtaria industriale në disa sektorë kyçë mundet, gjithashtu, të dëmtojë procesin e shpërndarjes së euros.

Volumet e pazakonshme të monedhave dhe të kartëmonedhave që do të shpërndahen, si edhe mosnjohja e kësaj paraje nga ana e publikut, konsiderohen si dy nga faktorët që mund t'i hapin rrugën aktivitetit kriminal.

Kartëmonedhat euro përmbajnë një numër tiparësh që i sigurojnë ato ndaj falsifikimit. Disa prej këtyre tipareve nuk i janë bërë ende të ditura bankave apo publikut.

BQE do të koordinojë masat kundër-falsifikimit me qendrat kombëtare të analizave për çdo shtet anëtar.

Masat kundër pastrimit të parave, duke përfshirë kufizimet mbi shumën e parave që mund të këmbehen pa njoftim paraprak, do të jenë akoma në fuqi gjatë tranzicionit.

Kush do të paguajë?

Asnjë nuk e di se sa do të kushtojë ky ushtrim, por është e qartë që çmimi do të jetë i lartë. ECOFIN ka vendosur që nuk ka vend për kompensim, ndërkohë që disa organizata bankiere kombëtare kanë ngritur pretendimin që ato po paguajnë një çmim tepër të lartë.

Në Holandë, një shumë prej 55 milionë euro është caktuar për të kompensuar bankat dhe shitësit për koston e ruajtjes dhe të shkëmbimit të parasë mbi bazën e sasisë së gildeve që ata heqin nga qarkullimi.

Në Belgjikë qeveria do të paguajë 20-25 milionë euro për shpenzimet e furnizimit.

Në Gjermani, Bundesbank po paguan një bonus për të inkurajuar furnizimin para afatit; ndërkohë që në Irlandë bankat do të marrin një pagesë të vogël për monedhat dhe kartëmonedhat vendase që do të kthehen në bankën qendrore.

Tabela 1. Prodhimi i kartëmonedhave dhe monedhave Euro para 1 janarit 2002*.

Shteti	Numri i kartëmonedhave që do të shtypen (milionë)	Numri i monedhave që do të shtypen (miliardë)
Austria	550	1.5
Belgjika	530	2.0
Finlanda	225	1.1
Franca	2,240	7.5
Greqia	597	1.3
Gjermania	4,342	17.0
Hollanda	659	2.8
Irlanda	222	0.9
Italia	2,380	7.2
Luksemburgu	46	0.1
Portugalia	536	1.3
Spanja	1,924	7.1
Totali për zonën e euros	14,251	49.8

* pa përfshirë stoqe shtesë të rastit.

